

PËRMBLEDHJE E ARSYEVE TË KTHIMIT TË LIGJIT NR. 36/2020

“PËR PROKURIMET NË FUSHËN E MBROJTJES DHE TË SIGURISË”

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 11482, datë 08.05.2020, ka vendosur: **“Kthimin në Kuvend për rishqyrtim të Ligjit nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”. Një përmbledhje e arsyeve të kthimit të këtij ligji, gjendet si më poshtë:**

Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 16 prill 2020, ka miratuar ligjin nr. 36/2020 *“Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”*.

Sipas relacionit shoqërues, ky ligj ka për qëllim *përcaktimin e rregullave për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë së institucioneve shtetërore dhe të mbrojtjes e sigurisë në Republikën e Shqipërisë*. Sipas hartuesve dhe propozuesve të nismës, është vlerësuar se, legjislacioni në fuqi, nuk mbulon tërësisht spektrin e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

Pavarësisht qëllimit pozitiv të deklaruar të kësaj nisme ligjore, mënyra e formulimit të disa prej dispozitave që lidhen me shtrirjen e zbatueshmërisë së këtij ligji, **cenojnë parime të rëndësishme kushtetuese**.

I. Mungesa e përcaktimit të qartë të fushës së zbatimit të këtij ligji sa i përket objektit jo shterues të mallrave dhe shërbimeve që mund të prokurohen sipas tij, cenon parimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, barazisë përpara ligjit, me pasojë diskriminimin e operatorëve të ndryshëm në treg, duke rritur mundësitë për dëm ekonomik ndaj financave të shtetit.

1. Ndryshe nga sa deklarohet në relacion, rezulton se formulimi i dispozitave konkrete të ligjit, *(duke patur në konsideratë edhe krahasimin me parashikimet e Direktivës së BE-së 2009/81/EC, që përcakton rregullat e prokurimit për autoritetet/entitetet kontraktuese që janë më të përshtatshme për prokurimet duke përfshirë një listë të specifikuar objektesh si pajisje ushtarake, pajisjet e ndjeshme dhe mallrat, punimet ose shërbimet e lidhura me to)*, **krijojnë hapësira për përdorimin e procedurave që përcakton ky ligj, edhe për mallra e shërbime që jo domosdoshmërisht lidhen drejtpërdrejt me sigurinë dhe mbrojtjen.**

Ligji del përtej përmbajtjes së Direktivës, si dhe krijon hapësirë për aplikimin e rregullave të tij për një gamë më të gjerë mallrash dhe shërbimesh, që jo domosdoshmërisht lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë.

Hapësira e gjerë mbi ligjin e zbatueshëm, që lihet në interpretim të institucioneve shtetërore, pa përcaktuar në mënyrë shteruese objektin dhe fushën e zbatimit të tij, çon në aplikimin e

mënyrave të kontraktimit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, sipas këtij akti, dhe jo sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, **procedura këto që në thelb parashikojnë të garantojnë në një masë më të madhe transparencën**, si një element shumë i rëndësishëm në prokurimin me fonde publike.

Rritja e transparencës është premisë për **nxitjen e pjesëmarrjes** në garë të operatorëve ekonomikë, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në rritjen e konkurrencës mes operatorëve ekonomikë, çka rrit **efiçencën dhe efikasitetin** në procedurat e prokurimit dhe për pasojë, **përdorimin më të mirë të fondeve publike**.

Për më tepër, aplikimi i procedurës që kërkon ligji nr. 36/2020, **për mallra dhe shërbime që nuk lidhen domosdoshmërisht me nevojën e garantimit të sigurisë dhe informacionit të klasifikuar në procedurat prokurorese**, prek drejtpërsëdrejti rrethin e operatorëve ekonomikë që mund të ofertojnë në këto procedura, duke bërë që të ketë një **trajtim jo të barabartë dhe diskriminues** për të gjithë operatorët ekonomikë në treg, ndryshe nga sa deklarohet në objektivat e kësaj nisme në relacionin shoqërues.

Kësisoj, paqartësia e nenit 1, të ligjit dhe mungesa e një liste shteruese të mallrave dhe shërbimeve që i nënshtrohet regjimit të prokurimit sipas këtij ligji, cenon direkt parimin themelor kushtetues të **lirisë së veprimtarisë ekonomike**, të përcaktuar dhe mbrojtur në **nenin 11, të Kushtetutës**.

Përfundimi i operatorëve ekonomikë nga procedurat e prokurimit për mallrat që jo domosdoshmërisht duhet t’i nënshtrohen një procedure prokurimi sipas rregullave më strikte për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë, përbën shkelje të parimit të barazisë përpara ligjit dhe diskriminim në kuptim të **nenit 18, të Kushtetutës**.

Nën dritën e kërkesave të nenit 11 dhe 18 të Kushtetutës, veçanërisht kur bëhet fjalë për prokurimin e mallrave apo shërbimeve me fonde publike, nevoja e mbrojtjes së interesit publik është më e lartë. Dhe kjo nevojë, nuk lidhet ekskluzivisht dhe vetëm me nevojën e mbrojtjes dhe të sigurisë në prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të caktuara që kërkojnë nivel më të lartë sigurie, por lidhet direkt edhe me nevojën për **përdorimin e fondeve buxhetore me transparencë, efikasitet dhe efiçencë**.

Kësisoj, mes këtyre dy nevojave të lidhura ngushtë me interesin publik, për të gjetur balancën në mbrojtjen e këtij interesi, dispozitat e ligjit duhet të kenë gjithmonë një qartësi të tillë në fushën e zbatimit të tij, **në mënyrë që të mos lënë vend për përdorimin e procedurave që nën justifikimin subjektiv apo mbulimin me nevojën për siguri, të krijohet një hapësirë e pakontrolluar për të shmangur konkurrencën e lirë përmes përjashtimit të operatorëve ekonomikë në prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të caktuara, që jo domosdoshmërisht**

lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë dhe mund të jenë të atilla që të kërkojnë mbrojtjen e elementëve të sigurisë edhe në prokurim.

Në rastin konkret, mungesa e qartësisë së fushës së zbatimit të ligjit të miratuar bën që jo në çdo rast të jetë transparent dhe i justifikuar përjashtimi nga procedurat e prokurimit sipas ligjit të përgjithshëm (nr. 9643/2006), dhe që automatikisht përjashton operatorët ekonomikë që mund të ofrojnë të njëjtat mallrat e shërbimet por që, nuk janë të pajisur me CSI apo CSP, dhe as nuk kanë pse të jenë të pajisur për të ofruar mallra e shërbime të tilla.

Kjo mungesë qartësie, krijon një hapësirë për interpretim në praktikë duke i dhënë një mundësi të pakufizuar autoritetit kontraktor, që për prokurimin e një malli apo shërbimi, mundet në mënyrë abuzive ta kategorizojë atë sikur lidhet me mbrojtjen dhe sigurinë, për të futur prokurimin nën një regjim të posaçëm ligjor, e të krijojë përjashtime pa shkaqe të përligjura.

Janë pikërisht këto procedura që parashikon ligji, e që nën justifikimin e nevojës për mbrojtje e siguri, bëjnë që të aplikohet një regjim ligjor i posaçëm, i cili realizohet nëpërmjet procedurës përzgjedhëse të kufizuar, me negociim me shpallje paraprake, me negociim pa shpallje paraprake ose me dialog konkurrues, procedura sipas të cilave, dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor ua vë në dispozicion një liste të mbyllur kandidatësh dhe ofertuesish për përgatitjen e ofertave.

Pikërisht kjo mundësi, ndërlidhur me hapësirën e pakufizuar që lë ligji për rrethin e mallrave dhe shërbimeve që mund të prokurohen nën këtë regjim ligjor të posaçëm, çon në shtrembërim direkt të konkurrencës dhe keqadministrim të përdorimit të fondeve publike.

Ky përjashtim ka efekt më të madh, pasi sipas këtij ligji, nën justifikimin e fushës së veprimtarisë specifike që mbulon, nuk parashikohet zhvillimi i një procedure prokurimi të hapur. **Ndërkohë që, edhe sipas konceptit të “procedurës me negociim”, rrethi i subjekteve pjesëmarrëse i nënshtrohet një tjetër tkurrjeje.**

Sipas përkufizimit të nenit 4, pika 24, *“Procedurë e kufizuar” është procedura, nëpërmjet së cilës çdo operator ekonomik mund të kërkojë të jetë pjesë, por vetëm operatorët ekonomikë të ftuar nga autoriteti/enti kontraktor mund të paraqesin një ofertë*”. Edhe në këtë rast, sipas këtij ligji, numri i operatorëve ekonomikë që mund të ftohen, praktikisht është i paracaktuar, për sa kohë kushtëzohet nga pajisja me CSI.

Mungesa e një procedure të hapur, e kombinuar me mospërcaktimin e qartë të fushës së veprimtarisë së këtij ligji, dhe mundësinë që ky ligj i ri ofron për të kufizuar rrethin e subjekteve, krijon hapësirë që çdo autoritet kontraktor të përzgjedhë paraprakisht, sipas

vullnetit të tij, fituesin e një procedure ende të pa shpallur. Pikërisht kjo, bie ndesh me parimet kushtetuese të sipërcituara.

Mungesa e qartë e rrethit të mallrave dhe shërbimeve që duhet t'i nënshtrohen procedurave të prokurimit sipas këtij ligji, bën që mallra apo shërbime të caktuara, edhe pse nuk lidhen direkt me fushën e mbrojtjes e të sigurisë, të rrezikojnë të prokurohen sipas këtij ligji, **duke bërë që ky ligj në këtë drejtim të jetë i padrejtë, arbitrar, dhe të mos justifikojë dot kufizimin e mundësive të operatorëve ekonomikë për të ofertuar në të tilla procedura.**

II. Dispozitat e ligjit nr. 36/2020 mbivendosen me parashikimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ndërkohë që përjashtimet nga fusha e zbatimit të ligjit nr. 36/2020, vënë në pikëpyetje qëllimin dhe objektin e ligjit në tërësi

Ndërsa vetë qëllimi dhe objekti i shprehur në pikën 1, të nenit 1, të ligjit nr. 36/2020, sipas të cilit ky ligj ka si objekt të tij *“kontratat që lidhen në fushat e mbrojtjes dhe të sigurisë”* mbivendoset me përcaktimet e nenit 5, pika 1, të ligjit nr. 9643/2006 që përcakton se është ky ligj i zbatueshëm për të gjithë procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes kombëtare.

Nëse ligji nr. 9643/2006, në vetvete ka përjashtime nga fusha e zbatimit, përjashtime këto që lidhen me elementët e sigurisë kombëtare, dhe që mund të kenë bërë të shfaqen në praktikë problematika në procedurat e prokurimit të mallrave dhe shërbimeve në këtë fushë, **sipas nenit 5 të ligjit nr. 36/2020, sërish këto lloj problematikash nuk mund të adresohen, sepse prokurimet për të cilat kërkohet ruajtje e informacionit që lidhet me fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, përjashtohen edhe nga zbatimi i ligjit të ri.**

Në këto kushte, kur ky ligj i ri nuk adreson ato shqetësime për transparencën e përdorimit të fondeve publike në blerjen e mallrave dhe shërbimeve që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë, ndryshe nga sa citohet në relacion dhe në nenin 1 të tij, atëherë lind pyetja se për cilat mallra dhe shërbime do të zbatohet?!

Kjo mungesë qartësie në fushën e zbatimit të ligjit, por edhe kundërthëniet në vetë dispozitat e tij në nenet 1, 2 dhe 5, krijojnë dyshime të arsyeshme se ky është një ligj më shumë, në vazhden e ligjeve të miratuara, për të futur në kanale prokurimi gjithnjë e më pak transparente, ato procedura prokurimi mallrash dhe shërbimesh, që nuk lidhen realisht me fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, por që do të interpretohen si të tilla nga autoritet kontraktore, sipas interesit momental.

Nën këto parashikime, duket sikur, qëllimi dhe objektivi real i këtij ligji, është të zbatojë regjimet e posaçme të prokurimit, vetëm për ato prokurime që mund të interpretohen si të përfshira në shkronjën “ç”, të nenit 1, të ligjit, e që lidhen me *punë, pajisje dhe shërbime*

ushtarake që, për arsye sigurie, përfshijnë, kërkojnë dhe/ose përmbajnë informacion të klasifikuar dhe trajtohen si punë, mallra dhe shërbime të klasifikuara.

Ky është dhe i vetmi parashikim i dispozitës së objektit dhe qëllimit të ligjit, që del edhe jashtë parashikimeve të vetë Direktivës që synohet të përafrohet.

Selektiviteti, diskriminimi dhe mungesa e transparencës së parashikimeve të këtij ligji, kthehen në shqetësime reale dhe të bazuara, nëse i lexojmë në raport me parashikimin e bërë po në nenin 5, pika 1, shkronja “i”, paragrafi i dytë i kësaj shkronje që përcakton se, për kontratat për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake, si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operationale, përfshirë teknologjinë dhe *softëare-t* e lidhura me këto mallra, klasifikimi sipas kësaj shkronje do të bëhet nga një komision i veçantë klasifikimi i ngritur në Ministrinë e Mbrojtjes. Përbërja, mënyra e organizimit dhe e funksionimit të komisionit do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pra, me këtë parashikim, synohet që aplikimi i rregullave përjashtuese të prokurimit, të bëhet vetëm për ato mallra që do të përcaktojnë realisht autoriteti politik i ministrit të Mbrojtjes.

Kjo dispozitë, e ndërtuar në këtë formë deleguese për plotësim me akt nënligjor pa dhënë asnjë orientim mbi rregullat, procedurat e parimet që do të duhet të respektohen, edhe nëse lind nevoja e krijimit të një liste të mallrave dhe shërbimeve që do të prokurohen sipas këtij ligji, jo vetëm që shkel direkt nenin 11, 18 dhe 118 të Kushtetutës, por është një rast i mirëfilltë i mundësisë që në praktikë, kjo e drejtë të përdoret për të devijuar nga fryma e ligjit, për të dalë jashtë kontrollit prej ligjit dhe detyrimit për zbatimin e tij.

Kjo mundësi që krijon Kuvendi përmes kësaj dispozite, përbën edhe gabimin më të rëndë në procesin legjislativ, pasi krijon hapësirë për shpërdorimin e fondeve publike, nën mbulimin e përjashtimit ligjor. Pikërisht ky është nga ato raste kur Kuvendi me një zgjedhje të keqmenduar ligjore i hap rrugën praktikave me risk të lartë korruptiv dhe klientelist.

Hapësira e lënë për zbatimin e këtij regjimi të ndryshëm ligjor në prokurimin publik, nën pretekstin e nevojës së prokurimit të mallrave dhe shërbimeve që lidhen me fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, ndryshe dhe nga sa përcaktohet në direktivën që deklarohet se synohet të përafrohet, po t'i referohemi përmbajtjes së nenit 12, të ligjit nr. 36/2020, shton jo vetëm paqartësinë mbi fushën e zbatimit të këtij ligji, por edhe përforcon dyshimin mbi hapësirën e qëllimshme të lënë për zbatim të tij me selektivitet.

Kjo për arsye se, neni 12, në shkronjat “b)” dhe “c)”, rendit si autoritete kontraktore jo vetëm ministritë dhe institucionet shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen, rendin publik dhe sigurinë kombëtare, por edhe:

“b) çdo autoritet kontraktor, i cili, sipas ligjit për prokurimin publik, zhvillon procedura prokurimi në sektorët utilitarë, si uji, energjia, shërbimi postar, transporti etj., në rastet kur, gjatë një procedure prokurimi për një punë, mall apo shërbim, përfshihen elemente që lidhen me një nga fushat e përmendura në shkronjën “a”;

c) çdo autoritet tjetër kontraktor, sipas ligjit për prokurimin publik, në rastet kur, gjatë një procedure prokurimi për një punë, mall apo shërbim, përfshihen elemente që lidhen me një nga fushat e përmendura në shkronjën “a”.”

III. Neni 14, i ligjit nr. 36/2020, u jep autoriteteve kontraktore edhe kompetencën e shqyrtimit dhe dënimit administrativ, që në logjikën e organizimit dhe mbikëqyrjes së procedurave të prokurimit publik, nuk i takon vetë autoriteteve kontraktore, por organeve mbikëqyrëse të procedurave të prokurimit publik.

Sipas ligjit, autoriteti kontraktor do të jetë me dy funksione. Nga njëra anë, organizator i një procedure prokurimi me të drejtë për përzgjedhjen e operatorëve që do të ftohen për të paraqitur oferta, dhe nga ana tjetër, përmes mjetit ndëshkues, **ka fuqi përjashtimi nga pjesëmarrja e procedurave të prokurimit publik në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, për një periudhë të gjatë kohore.**

Në një proces të tillë administrativ, përmbysset parimi i kontrollit dhe balancës, dhe shqyrtimit administrativ nga një organ epror pa konflikt interesi në lidhje me procedurën.

IV. Neni 16, i ligjit nr. 36/2020, që përcakton detyrat e autoritetit përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar, është një nen në tejkalim të objektit dhe qëllimit të këtij ligji dhe krijon mbivendosje me ligjin e posaçëm që rregullon kompetencat e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

Autoriteti përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), është krijuar dhe i ka të përcaktuara detyrat e saj që lidhen ekskluzivisht me ruajtjen, klasifikimin dhe administrimin e informacionit të klasifikuar, në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar ‘sekret shtetëror’”, i ndryshuar.

Përsëritja posaçërisht e kompetencave të këtij organi, siç bëhet në shkronjën “b)” të nenit 16 të ligjit nr. 36/2020, që përcakton se:

“b) kur ekzistojnë rrethanat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për informacionin e klasifikuar, ai:

- i) lëshon ose jo, heq, pezullon certifikatën e sigurimit industrial të operatorit ekonomik dhe certifikatën e sigurimit të personelit të punonjësve të operatorit ekonomik;*
- ii) konfirmon rekordet dhe vlefshmërinë e certifikatës së sigurimit industrial dhe të certifikatës së sigurimit të personelit për operatorët ekonomikë të huaj dhe punonjësit e tyre, përpara pjesëmarrjes në procedurat e një prokurimi të klasifikuar;*
- iii) autorizon operatorin ekonomik për administrimin e informacionit të klasifikuar në kushtet e zbatimit të kontratës së klasifikuar;*
- iv) akrediton sigurinë e sistemeve të komunikimit dhe të informacionit dhe autorizon, sipas rastit, përdorimin e tyre nga çdo operator ekonomik dhe autoritet kontraktornë kushtet e një prokurimi të klasifikuar apo gjatë zbatimit të kontratës së klasifikuar;”*

bën që DSIK-ja, të mund të aplikojë me hyrjen në fuqi të këtij ligji, procedura të ndryshme nga ato që aplikon sipas ligjit të posaçëm për informacionin e klasifikuar, duke lëshuar certifikata të sigurimit industrial, të dedikuara për pjesëmarrje të operatorëve ekonomikë në procedura prokurimi për ato mallra dhe shërbime që vlerësohen nga autoritetet kontraktore si në funksion të mbrojtjes dhe sigurisë.

Kjo dispozitë, bëhet akoma më e rrezikshme për parimet e transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta, kur këto kompetenca që i renditen në këtë ligj DSIK-së, e që në shumicën e tyre lidhen me lëshimin, heqjen, pezullimin e certifikatës së sigurimit industrial të operatorit ekonomik dhe certifikatën e sigurimit të personelit të punonjësve të operatorit ekonomik, (që përbëjnë akte thelbësore për të mundësuar pjesëmarrjen e operatorëve në këto procedura), **nuk referojnë në asnjë procedurë, parim apo kriter orientues për ushtrimin e tyre.**

Për më tepër, kjo situatë rëndohet kur sipas parashikimit të nenit 49 në tërësi, por në veçanti pika 5, të ligjit nr. 36/2020, heqja e CSI-së apo mosrinnovimi i saj, përbëjnë shkaqe për zgjidhjen e njëanshme dhe të menjëhershme të kontratës me autoritetin kontraktor.

Për këtë, është e nevojshme që miratimi i këtij ligji të ri, të ecë paralel me ndryshimin dhe përmirësimin e ligjit bazë që përcakton organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni. **Kjo do të hiqte mundësinë që të aplikohen procese të diferencuara referuar qëllimit të njëjtë për të cilin Certifikatat e Sigurimit Industrial lëshohen.**

Përmirësimi i këtyre dy ligjeve, duhet të shoqërohet edhe me garantimin e të njëjtit standard sigurie edhe për nënkontraktorët. Kësisoj, dispozita e nenit 52, të ligjit, që lejon nënkontraktimin, nuk bën asnjë referencë në nevojën për përmbushjen e detyrimeve që lidhen me informacionin e klasifikuar dhe kërkesat që duhet të përmbushë në këtë drejtim operatori që do të nënkontraktohet.

V. Neni 34, i ligjit nr. 36/2020, i cili përcakton mundësinë e zvogëlimit të numrit të kandidatëve të përshtatshëm në procedurën e kufizuar, procedurën me negociim, me shpallje paraprake, ose të dialogut konkurrues, përbën në vetvete një mekanizëm tjetër diskriminues dhe cenues të lirisë kontraktuale.

Në pikën 1, të nenit 34, përcaktohet se autoriteti kontraktor ka si “opcion” zvogëlimin e numrit të kandidatëve të përshtatshëm për të cilin autoriteti kontraktor do të paraqesë një ftesë për ofertë, për të negociuar ose për të marrë pjesë në dialog. **Në vetvete kjo përbën një ndryshim të rregullave të prokurimit në mes të procedurës, duke lënë vend për abuzime dhe mënjanimë të pandershme të operatorëve ekonomikë nga mundësia për të qenë pjesë e konkurrencës.**

Sipas kësaj dispozite, autoriteti kontraktor edhe pse mund të ketë në historikun apo në arkivën e tij një numër mbi 3 operatorësh që mund të ftojë dhe me të cilët mund të ketë bashkëpunuar më parë, sërish sipas kësaj dispozite, mund ta kufizojë këtë numër, duke paraselektuar të paktën vetëm tre. Apo në raste të tjera, kjo hapësirë e ligjit, krijon mundësinë që ndonëse të gatshëm për të depozituar ofertën pas njoftimit të kontratës, të jenë për ilustrim 5 operatorë, nëse 3 prej tyre rakordojnë çmimin që do t'i propozojnë autoritetit kontraktor jashtë kriterëve konkurruese, për t'u paraqitur si bashkim operatorësh, përdorimi i opsionit të zvogëlimit të numrit të kandidatëve të përshtatshëm nga autoriteti kontraktor në këtë moment nga 5 në 3, ose nën numrin 3, do të sillte deformimin tërësor të procesit të prokurimit, çmime më të larta të mallrave dhe shërbimeve të prokuruar, me rrishtje të cilësisë dhe kohës së ofrimit të shërbimeve.

Këto rrishte që mund të ndodhin në situata praktike, lidhen pikërisht me listën e ngushtë të subjekteve që mund të operojnë në këtë fushë dhe natyrën e kufizuar dhe të mbyllur të procedurave që ndiqen sipas këtij ligji, ku është e pritshme që kandidatët të njihen nga autoritetet kontraktore, ashtu sikundër të njohin apo të bashkëpunojnë në mënyrë të vazhduar me njëritjetrin.

VI. Ligji nr. 36/2020 nuk përmban procedura të qarta mbi ankimin administrativ ndaj vendimmarrjes së autoriteteve kontraktore. Veçanërisht neni 53 i tij që përmban dispozitën mbi procedurën e ankimit administrativ, nuk përcakton qartë momentet e kryerjes së ankimit për secilën fazë të prokurimit, duke filluar nga përgatitja e dokumenteve të tenderit dhe përcaktimi i specifikimeve teknike.

Për më tepër, në pikën 11 të këtij neni, përcaktohet se: *“Çdo ankesë në komisionin e prokurimit publik bëhet kundrejt pagesës. Rregullat dhe tarifat e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.*

Kushtëzimi i mundësisë së ankimit, përmes pagimit të një tarife, për të tepër kur dispozita nuk përcakton asnjë nivel minimal/maksimal, apo qoftë dhe orientues për përcaktimin e tarifës

nga Këshilli i Ministrave, **rrezikon të çojë në miratimin e një tarife që jo vetëm mund të jetë diskriminuuese, por edhe të cenojë rëndë ushtrimin efektiv të mjeteve të ankimit.**

Nevoja e përcaktimit të një tarife, sado që mund të justifikohet si mjet për të eliminuar ankesat e pabazuara dhe që synojnë të keqpërdoren nga operatorë të ndryshëm për të vonuar apo penguar procedurën e prokurimit, nëse është në nivele të larta në raport me zhvillimin ekonomik të vendit, apo në raport me të ardhurat mesatare vjetore të operatorëve ekonomikë që operojnë në fushat specifike për të cilat mund të zbatohet ky ligj, përbën pengesë reale për ushtrimin e së drejtës së ankimit.

Ky ligj bie ndesh me parimet e mbrojtura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke krijuar pabarazi në trajtimin e operatorëve ekonomikë, diskriminim të tyre, dhe duke i penguar të ushtrojnë të drejtën për liri të veprimtarisë ekonomike, edhe në raport me mundësinë e hyrjes në marrëdhënie kontraktuale me autoritetet kontraktore.

Deformimi i konkurrencës shkakton pasoja direkte në cilësinë e mallit/shërbimit të prokuruar, që ka impakt direkt dhe në kosto financiare, duke ulur transparencën e shenjtë të administrimit të fondeve publike.

Gjithashtu, përdorimi i një regjimi të posaçëm prokurues, që shmang procedurat e hapura të prokurimit, dhe që orienton drejt një rrethi të paracaktuar operatorësh ekonomikë, përveçse bart rrezikun konsistent të një rritjeje fiktive të çmimeve dhe kostove, orienton drejt fituesve të paracaktuar apo të diktuar nga marrëveshje potencialisht të fshehura.

Përdorimi i një regjimi të veçantë prokurues, që në vetvete cenon konkurrencën e lirë dhe trajtimin e barabartë, mund të justifikohet vetëm për arsye që lidhen me nevojën reale të mbrojtjes së sigurisë.

Por fushat ku nevojitet mbrojtje dhe siguri, janë të kufizuara dhe për këtë qëllim, duhet të jenë të përcaktuara qartë dhe në ligj. Përmbajtja e këtij ligji, nuk është në përputhje me këto kërkesa, duke u kthyer në premisë për praktika korruptive me fondet publike.

Sa më sipër, janë shqetësime që duhet të merren në konsideratë nga legjislatori gjatë rishqyrtimit të këtij ligji, duke mbajtur në vëmendje nevojën për përcaktimin e rregullave të qarta dhe transparente në procedura që lidhen me prokurimin me fonde publike, rregulla këto që duhet të garantojnë efektivitet, eficiencë dhe mirëpërdorim të këtyre fondeve.

Dekreti i Presidentit dhe arsyetimi bashkëlidhur gjenden në faqen zyrtare në internet të Institucionit të Presidentit të Republikës www.president.al